



Pranuar / Dostiguar Prinjeho / Prifato Received / Delivered	17.08.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot for Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPAMSHUK	5701/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.947/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.947/2023 të datës 12.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted], me adresë banimi [redacted], kundër organit të punësimit/Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.947/2023 e datës 12.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] me datën 12.07.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 5127/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me shpalljen e konkursit me datën 22.06.2023 sipas numrit të referencës RN00011940 nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (tutje KRPP) për pozitën Drejtor i Departamentit për Monitorim në KRPP me pretendimin ankimor se nuk janë plotësuar kërkesat ligjore për shpalljen e pozitës lëvizje paralele nga se sipas pretendimit të ankuesit KRPP duhet të rishpall konkurs për avancim për të njëjtën pozitë Drejtor i Departamentit për Monitorim, pasi sipas tij është konsumuar elementi i shpalljes së konkursit për lëvizje paralele me faktin se konkursi i shpallur i datës 07.02.2023 ishte anuluar më datë 25.04.2023 dhe në këtë mënyrë ka rezultuar si i pasuksesshëm e që tashmë do të duhej të shpallej konkurs për Avancim për të njëjtën pozitë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 14.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek KRPP-ja, ndërsa kjo e fundit me datën 20.07.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5127/2023 të datës 12.07.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt emërimit të datës 14.02.2012; Vendim me nr.68/2021 i datës 13.10.2021; Vendim me nr.20/2023 i datës 14.03.2023; Konkursi për lëvizje paralele i datës 07.02.2023 nga KRPP; Njoftimin e datës 25.04.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me anulimin e konkursit; Kërkesë e ankuesit e datës 26.06.2023 për Njësia e Burimeve Njerëzore; Konkursi për lëvizje paralele i datës 22.06.2023 nga KRPP; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Njoftimin e datës 22.03.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Email i datës 14.03.2023; Emaili i datës 29.05.2023; Procesverbal nga zyra e kryetarit e datës 22.05.2023; Lista e kandidateve të aprovuar në SIMBNJ; Përgjigjen në ankesë të datës 20.07.2023 nga KRPP; Email i datës 18.07.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Përgjigjen në kërkesë të datës 18.07.2023 nga KRPP; Email i datës 03.07.2023 nga ankuesi; Email i datës 26.06.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore, akt emërimi AE.Nr.11/2021 i datës 08/10/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pa lejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në KRPP fillimisht sipas Akt emërimit të datës 14.02.2012 kishte mbajtur pozitën "Koordinator i departamentit" në kuadër të Departamentit për Mbikëqyrje dhe Monitorim, sipas akt emërimit të fundit mbanë pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Analiza sipas akt emërimit AE.Nr.11/2021 të datës 08/10/2021, ndërsa i njëjti përmes vendimit 68/2021 të datës 13.10.2023 të Kryetarit të Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik është caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit për Monitorim.

I njëjti kishte aplikuar në konkursin e shpallur të datës 07.02.2023 nga KRPP për lëvizje brenda kategorisë me numër të referencës RN00010923 në pozitën "Drejtor i departamentit për monitorim". KRPP me datë 20.07.2023 përmes përgjigjes në ankesën e ankuesi ka njoftuar Këshillin lidhur me procedurën në fjalë respektivisht ka njoftuar se kjo procedure nuk kishte përfunduar duke arsyetuar **citoj:** ".....ju njoftojmë se për konkursin me RN00010923 të datës 07.02.2023 për lëvizje paralele për pozitën "Drejtor i departamentit për monitorim", KRPP nuk e ka themeluar komisionin përzgjedhës sepse e kishte të pamundur të krijoj sipas nenit 46 të rregullores, andaj edhe ne takimin e datës 22.05.2023 në mes të Bordit të KRPP-së dhe Drejtorëve të Departamenteve ku si rrjedhojë nuk e ka vazhduar procedurën e rekrutimit".

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me objektin e kësaj ankese duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...". Ndërlidhur më këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: "Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo

mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë që i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik, ndërsa neni 125 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se: "1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: heshtja administrative)" pastaj me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 i po këtij ligji ka përcaktuar se: "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ". Përkatësisht sipas këtyre dispozitave ligjore rezulton se çdo nëpunës civil i cili pretendon se një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) të organit gjegjes të punësimit i është cenuar ndonjë e drejtë, mund të parashtroj ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga ana e organit të punësimit dhe ankuesi, nuk ka gjetur dëshmi se ankuesi [REDACTED] ka parashtruar ankesë tek KRPP apo në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me procedurën e rekrutimit në fjalë sipas konkursit të datës 07.02.2023 edhe pse e njëjta procedurë në lidhje me këtë konkurs nuk kishte përfunduar gjegjësisht me asnjë provë nuk është argumentuar se i është shkelë apo cenuar ndonjë të drejtë nga marrëdhënia e tij e punës që është rezultat i anulimit të këtij konkursi sipas njoftimit të datës 25.04.2023, për më tepër ankuesi kishte aplikuar në këtë konkurs të datës 07.02.2023 ndërsa përmes vendimit me Nr.20/2023 të datës 14.03.2023 i ishte refuzuar aplikimi me arsyen se i njëjti nuk plotëson kriteret për lëvizje brenda kategorisë, nga se i njëjti nuk ka pozitë ekuivalente me pozitën që është shpallur sipas këtij konkursi, ndërsa përkundër që sipas këtij vendimi ankuesi kishte të drejtë në ankesë por se nga shkresat e lëndës të ofruara nga palët nuk na është ofruar ndonjë provë se i njëjti konformë këshillës juridike ka ndër marrë veprimet përmes mjeteve juridike, as ndaj këtij vendimi e as ndaj njoftimit të datës 25.04.2023 për anulim të konkursit të datës 07.02.2023.

Kështu që në vlerësim të Kolegjit e në kuptim nga ajo që u tha si më lartë ankesa e ankuesit e datës 12.07.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas numrit të protokollit 5127/2023 është e parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ", si dhe nenit 127 paragrafit 4 me të cilin parashihet se:".... 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimimit brenda afateve ligjore sipas dispozitave të lartpërmendura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Prandaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa e ankuesit është e pa lejuar.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit e shpallur nga KRPP për pozitën Drejtor i departamentit për monitorim-Lëvizje brenda kategorisë me datën 22.06.20023 sipas numrit të referencës RN00011940, lidhur me sqarimin se kush konsiderohet palë në procedurën administrative, Kolegji i'u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët:

1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative". Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjial, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjial, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë", kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se nga provat e lëndës nuk ka gjetur dëshmi se ankuesi ka qenë kandidat pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit në fjalë apo se nga kjo procedurë i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i tij, gjegjësisht i njëjti nuk e ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesë lidhur me këtë procedurë të rekrutimit, andaj si rrjedhojë dhe bazuar në këtë konstatim si dhe duke iu referuar nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankuesit është e pa pranueshme.

Pas konstatimeve si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbrojtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.947/2023, datë 17/08/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në KRPP ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së